

S T A T U T I
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Dentour Albania” SH.P.K.

Sot, më datë 15.09.2022, Ortakët e shoqërisë “**Dentour Albania**” SH.P.K., **Ermir GJETA** dhe **Kisman GRECA**, bazuar në vullnetin e tyre të lirë themeluan shoqërinë “**Dentour Albania**” SH.P.K., në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare”, i ndryshuar, dhe vendosën të hartojnë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Dentour Albania**” SH.P.K.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 15.09.2022 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin
“Dentour Albania” SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

Z. Ermir GJETA, atësia: Gjergj, i datëlindjes 06.10.1988, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me numër: 036332823 dhe Numër Personal: I81006066A, lindur në Q.Rrëshen dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.8, Rruga “Siri Kodra”, Ndërtesa Nr.43, Kodi postar 1017.

Z. Kisman GRECA, atësia: Tasim, i datëlindjes 06.05.1992, mbajtës i dokumentit pasaportë me numër: BC8608205 dhe Numër Personal: J20506088P, lindur në Elbasan, dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.7, Rruga “Ndre Mjeda”, Nd.5; H.4; Ap.48, Kodi postar 1023.

Neni 2
Selia

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Tiranë, Njësia Administrative Nr.10, Rruga “Çamëria”, Zona Kadastrale 8380, Pasuria Nr. 6/50+2-2; Volumi 3, Faqe 39; Pallati 18; SH.2; Ap.2. Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qëndra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar.

**Neni 4
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Organizim guida turistike, udhëtime turistike brenda dhe jashtë Shqipërisë. Organizimi dhe promovimi i turizmit dentar, duke përshirë ndërmjetësimin midis klientëve tanë dhe klinikave të licënsuara dentare e stomatologjike, si dhe konceptim dhe programimin e gjithë kohës së qëndrimit në Shqipëri (bileta avioni, rezervim hoteli, programim vizitash kulturore në objekte të ndryshme turistike), transfertat Aeroport-Hotel- Aeroport dhe Hotel-Klinikë- Hotel, asistencë turistike gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Shqipëri.

Organizim aktivitetesh rekreative, kulturore, sportive, festash në gjithë vendin. Zhvillim i guidave malore, detare, fushore brenda dhe jashtë vendit, zhvillimi dhe suport i sporteve, ecje malore, ski, alpinizem, serf, zhytje nënüşore,etj. Promovimin e Turizmit në Shqipëri, në zonat rurale dhe ne zonat turistike. Shoqërim turistesh vendas dhe të huaj. Organizim turesh brenda dhe jashtë vendit. Pushime dhe udhëtime me krociera. Shoqëria bashkëpunon me agjenci të tjera turistike, udhëtimi, klinika dentare e stomatologjike, shoqëri transportesh, etj, vendase dhe / apo të huaja, hotele, resorte, restorante, individë, familje, etj, që kanë objekt veprimtarie të njëjtë me të apo që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë.

Veprimitari të tjera në fushën e turizmit, pjesëmarrje në panaire, hapje agjensi udhëtimi dhe marketing, veprimitari në fushën e hotelerisë, bar kafe, restorante, etj.

Shoqëria mund të kryeje cdo operacion tregtar, si edhe të blejë dhe të shesë ose të marrë me qera ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, të themeluara apo ne themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm më të vetin, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjispcionin në fuqi.

**KREU II
KAPITALI**

**Neni 5
Kapitali themeltar**

Kapitali fillestari i shoqërisë është 500 000 (pesëqind mijë) leke. Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e shoqerisë është në përputhje me kontributet e tyre.

Ortakët themelues janë:

Z. Ermir GJETA, zotëruar i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Klisman GRECA, zotëruar i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpermjet emërimit të një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve perderisa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimarrës

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshjet e meposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te ketij neni
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkresë ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkresë ose mesazh elektronik, duhet te permboje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se para 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk eshte thirrur sipas kesaj menyre, ajo mund te marre njoftime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 20 % te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 Te Ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit

88 te ligjit siper mendur.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungesë se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite

Neni 11 Marrja e Vendimeve

Asambleja e pergjithshme e Ortakeve, vendos me tre te katerat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shperblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padje ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nj i perfaquesuar i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interesit, ashtu sic eshte dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 Administrimi

Administrator i shoqërisë emërohet:

Z. Z. Klisman GRECA, atësia: Tasim, i datëlindjes 06.05.1992, mbajtës i dokumentit pasaportë me numër: BC8608205 dhe Numër Personal: J20506088P, lindur në Elbasan, dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.7, Rruga "Ndre Mjeda", Nd.5; H.4; Ap.48, Kodi postar 1023.




Z. Klisman GRECA, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë ripërtëritje.

Emer Mbiemer

Klisman Greca

Nënshkrimi



Administratori i shoqerisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakerisë.

**Neni 14
Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) te përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) te kujdeset përmbraktjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisin dhe nënshkruejë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmbraktuese tregtare, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) te krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmiratim; që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) te kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmbraktuese;
- f) te raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmbraktuese;
- g) te kryjene detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtezakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat përmbraktuese tregtare të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojnë bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite që lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.



Neni 15
Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

KREU IV
VITI FINANCIAR- EKSPERTËT



Neni 16
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Pëergjithshme e Ortakëve, miraton Llogarite vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijuimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

Neni 17
Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille. i ngarkuar nga ana e ortakeve

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V
PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË

Neni 18
Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizimi i shoqerisë: Bashkimi - Ndarja

Shoqëria mund te ndahet , bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se pergjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në ketë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Dentour Albania"

Ermir GJETA

Klisman GRECA

